

**REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - MARS 2024**

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	04.03.2024	Kërkesë për interpretim mbi vendimin për refuzimin e lejes	12.03.2024	<p>Në përgjigje të shkresës Tuaj, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Referuar Nenit 27, të Ligjit Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit janë përkatësisht: Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Kryetari i Bashkisë. Bazuar në legjislacionin mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit, këto dy autoritete (KKT dhe Kryetari i Bashkisë), nuk janë në pozita varësie me njëri-tjetrin pra, KKT nuk është organ epror i Kryetarit të Bashkisë dhe si rrjedhojë autoriteti vendor i zhvillimit të territorit (në rastin konkret Bashkia Shkodër), është institucioni kompetent për zbatimin e legjislacionit përkatës mbi planifikimin dhe zhvillimin urban, brenda kufirit territorial administrativ, të saj. Për sa u parashtrua më sipër, theksojmë se Bashkia Shkodër mbetet autoriteti i vetëm përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij aplikimi me qëllim pajisjen me Leje Zhvillimi, në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, si dhe legjislacionin sektorial në fuqi</p>	E plotë	Nuk ka
2	18.03.2024	Kërkesë për pajisje me kopje të plotë të akteve të vendimit....	08.05.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije, si më poshtë vijon: Pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve aplikimi ....për miratimin e Lejes së Ndërtimit</p>	E plotë	Nuk ka